



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 755/1 prot.

Tiranë, më 01.10.2020

VENDIM
Nr.106, datë 01.10.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 68 DATË 31.05.2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 68 datë 31.05.2019, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 30, datë 19.04.2019, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin Paralajmërues nr. 68, datë 31.05.2019, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, me shkresën nr. 431/14 prot., datë 12.07.2019, *“Dërgohet dokumentacioni mbi zbatimin e vendimit të KMSHC-së”*, ka informuar Komisionerin në

lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit, duke bashkëngjitur një pjesë të dokumentacionit që provon zbatimin e tij. Gjithashtu, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në rrugë elektronike, në datën 17 shtator 2020, ka dërguar pjesën e dokumentacionit që mungonte në shkresën e sipërpërmendur dhe që vërteton zbatimin e plotë të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim. Konkretisht:

1. Departamenti i Administratës Publike, me mbështetjen e grupit të ekspertëve të projektit të financuar nga fondet IPA 2014, *“Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike”*, ka filluar punën në drejtim të klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil dhe më gjerë.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë formularin e vlerësimit të punës të titullarit të institucionit (*i cili është anëtar i TND-së*).
3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka finalizuar procesin e vlerësimit të punës në shtator të vitit 2020, në përputhje me rekomandimin e Komisionerit.
4. Njësia e burimeve njerëzore ka plotësuar të gjitha dosjet individuale të nëpunësve civilë me të dhënat e munguara sipas përcaktimeve ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 68, datë 31.05.2019, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 68, datë 31.05.2019.

3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, si dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha